



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. *129*... Prot.

Tiranë, më *11* . *01* .2022

Shpallje e kërkesës për aplikime për vlerësues të testeve të provimeve të Maturës Shtetërore

Qendra e Shërbimeve Arsimore shpall kërkesën për aplikime për vlerësues të përgjigjeve të nxënësve në testet e provimeve të Maturës Shtetërore.

Shpallja e kërkesës është e hapur për të gjithë të interesuarit që ushtrojnë profesionin e mësuesit, si në institucionet publike, edhe në ato private.

Kandidatët e interesuar, përpara se të fillojnë përgatitjen e dokumenteve për aplikim, duhet të sigurohen që i plotësojnë kriteret e shpallura për përzgjedhjen e kandidatëve.

Kriteret që duhet të plotësojnë mësuesit që aspirojnë për t'u bërë vlerësues janë:

Kandidati për vlerësues në provimet/vlerësimet kombëtare është mësuesi që:

- a) ushtron profesionin e mësuesit sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi;
- b) ka të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune si mësues;
- c) ka dhënë lëndën të paktën 1 (një) herë në të gjitha klasat e nivelit arsimor;
- d) ka të paktën kategorinë e kualifikimit “mësues i kualifikuar” dhe është vlerësuar në provimin e kualifikimit të mësuesve me të paktën “mirë”;

- e) ka pervoje ne vleresimin e pergjigjeve te pyetjeve ne provimet/vleresimet kombetare;
- f) ka aftësi shumë të mira kompjuterike.

Aplikimi

Dokumentet e nevojshme që kandidati i interesuar duhet të dorëzojë, dhe mënyra e aplikimit përcaktohet si më poshtë. Të dhënat e kandidatëve do të grumbullohen duke respektuar Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:

- ✓ Formular aplikimi (i cili ndodhet këtu <https://www.qsha.gov.al/forma-aplikimit/>);
- ✓ Letër motivimi e aplikantit;
- ✓ CV e aplikantit sipas modelit Europass;
- ✓ Fotokopje e dokumentit të identifikimit të vlefshëm;
- ✓ 2 (dy) rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të njësisë arsimore vendore për cilësinë e punës dhe qëndrimin etik;
- ✓ Vërtetim që ka 5 (pesë) vitet e fundit përvojë pune si mësues;
- ✓ Kopje të dëshmisë së provimit të kualifikimit, ku të jetë vlerësuar me të paktën “mirë”;
- ✓ Formular vetëdeklarimi që aplikanti nuk ka qenë i dënuar penalisht;

Procedura e aplikimit

Qendra e Shërbimeve Arsimore do të pranojë vetëm aplikime që janë përcjellë me postë në QSHA. Nuk pranohen aplikime dorazi.

Afati i dorëzimit të aplikimeve dhe procedura e vlerësimit

Aplikimet do të drejtohen pranë QSHA, **duke filluar nga data 11.01.2022 deri më 31.01.2022**. Deri më datë 04.02.2022, do të njoftoheni në adresat tuaja elektronike, nëse jeni pranuar për të ndjekur kursin trajnues në QSHA.

Qendra e Shërbimeve Arsimore organizon procesin e vlerësimit, pranimit, regjistrimit dhe certifikimit të kandidatëve sipas urdhrit nr.86, datë 28.09.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e kursit trajnues dhe të provimit për pajisjen me certifikatë të hartuesve të testeve dhe vlerësuesve të provimeve/vlerësimeve kombëtare”, të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm.

Kursi trajnues zhvillohet me kohë të pjesshme, pa shpëputje nga puna.

Në përfundim të kursit trajnues, kandidatët i nënshtrohen provimit për vlerësues. Provimi zhvillohet sipas përcaktimeve të urdhrit nr.86, datë 28.09.2020, “Për miratimin e rregullores për zhvillimin e kursit trajnues dhe të provimit për pajisjen me certifikatë të hartuesve të testeve dhe vlerësuesve të provimeve/vlerësimeve kombëtare”. Një kandidat e fiton certifikatën për vlerësues, kur është kalues në provim.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Aurora Balliu
Aurora BALLIU

